

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E mërkurë, 22 shkurt 2023

2 [Deklarata hapëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes dhe mirë se jeni kthyer.

8 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem a mund të thërrisni
9 çështjen.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
11 është çështja KSC-BC-2020-04, Prokuroria i Specializuar kundër
12 Pjetër Shalës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, znj. Sekretare.

15 Shumë mirë.

16 Tani do t'ju kërkoj palëve që të na thonë se kush janë të
17 pranishëm nga ana e tyre në sallë. Do të fillojmë nga
18 Prokuroria.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
20 Gjykatës. Sot ZPS-ja përfaqësohet nga Aleks Whiting, ushtrues
21 i detyrës si Prokurori i Specializuar; Maria Cristina
22 Manolescu, stazhiere ligjore; Line Pederson, menaxhere e
23 çështjes; edhe, Gaia Pergolo, Eva Wyler dhe Filippo De
24 Minicis, prokurorë të asociuar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 Faleminderit.

2 Mbrojtja e Viktimave.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Simon Laws,
4 përfaqësoj viktimat në këtë çështje, së bashku me
5 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska dhe gjithashtu edhe znj.
6 Kait Wei Ng.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit.

9 Z. Avokat i Mbrojtjes, fjala për ju.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
11 Unë jam Jean-Louis Gilissen, jam këtu me të njëjtën përbërje
12 ekipi siç isha dje në mëngjes. Së pari, kemi z. Pjetër Shala,
13 sigurisht. Pastaj kemi z. Hedi Aouini, bashkëmbrojtës; Leto
14 Cariolou; kemi gjithashtu edhe Katerina Charitou, oficere
15 ligjore; dhe, Juliette Healy, ndihmëse për rishikimin e
16 provave; Francisca De Kastro, asistente për rishikimin e
17 provave; Judit Kolbe dhe pjesa tjetër e ekipit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Tani Zyra Administrative.

21 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

22 Unë jam Ralph Roche nga Zyra e Shërbimeve Gjyqësore.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

24 rregull.

25 Ju jeni përpara Trupit Gjykues I.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 Dje dëgjuam prezantimet hyrëse nga Prokurori dhe nga
2 Mbrojta e Viktimave. Ndërkohë që sot jemi për të dëgjuar
3 prezantimin hapës të Avokatit të Mbrojtjes dhe deklaratën pa
4 betim të z. Shala.

5 Juve ju është caktuar dy orë për këtë seancë, i nderuar
6 avokat. Nuk e di ka ndonjë ndryshim në vlerësimin e bërë
7 lidhur me këtë pikë?

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Nuk e di me siguri. Shpresojmë që
9 të jemi më të shkurtër sesa kaq.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull.

12 Jeni të autorizuar që të përdorni mjete vizuale si dhe
13 mjete të tjera të cilat ju nevojiten për të bërë prezantimin
14 fillestar. Jemi informuar që një pjesë e materialit dhe e
15 mjeteve vizive, nuk do të tregohen në seancë publike.

16 E mirë, atëherë, fjala për juve, Avokat Mbrojtës.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
18 Gjykatës. Faleminderit, znj. Kryegjykatëse që më dhatë fjalën.

19 Po mundohem që të mbaj veten sepse ky është një moment
20 shumë i rëndësishëm për z. Shala. Kjo është hera e parë që ai
21 ka mundësi që të jetë shumë i qartë në këtë proces gjyqësor.
22 Më duhet të them që në fillim të kësaj deklarate hapëse, dua
23 ta bëj të qartë që dje dëgjova, dëgjova emocione, emocionet e
24 shprehura nga disa prej folësve, nga kolegët e mi. Dhe
25 dëshiroj të them se unë nuk kam asnjë dyshim për sa i takon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 4

1 ndarjes së dhimbjes, apo të raportuar për ngjarje të tmerrshme
2 për të cilat po flasim dhe padyshim për t'ju bërë juve të
3 jetoni fatkeqësinë e personave të cilët pretendojnë që të jenë
4 viktima. Gjithashtu ne ju kërkojmë që juve t'i përdorni këto
5 parashtime pas faktit, në mënyrë të tillë që drejtësia të
6 bëhet.

7 Unë personalisht synoj ta respektoj këtë. Unë synoj që të
8 respektoj plotësisht vuajtjen dhe dhimbjen e atyre që kanë
9 qenë viktima. Ne e dimë, e dimë që në Kosovë në vitin 1999,
10 askush nuk e mohon këtë gjë, që ka pasur 900.000 viktima të
11 drejtpërdrejta të abuzimeve të shumta dhe të represionit mizor
12 të politikave shtetërore. Kjo nuk është politikë. Kjo mund të
13 thuhet qartë. Kjo është e vërteta. Dhe ata njerëz janë viktima
14 të vendimeve të qëllimshme të marra në nivelet më të larta të
15 shtetit serb për të vënë në jetë një agresion të vërtetë
16 kundër popullsisë civile. Kjo është e vërteta. Askush nuk e
17 mohon këtë gjë. Kjo është një gjë e tmerrshme.

18 Policia, shërbimet sekrete, madje edhe ushtria, pra, të
19 gjitha mjetet e disponueshme për një shtet, madje edhe më
20 tepër sesa kaq, ishin në dispozicion të sulmeve të tilla,
21 përfshirë këtu grupe paramilitare mizore që vinin veçanërisht
22 nga Serbia në Kosovë, pra, kishte sulme të cilat fokusonin
23 popullsinë shqiptare dhe vërtetë kanë kryer një sulm të
24 përgjithshëm dhe diskriminues dhe pa dallim fare ndaj
25 popullsisë së pafajshme.

1 Bëhet fjalë për burra, për gra, për të rinj, për fëmijë
2 të shumtë. Dhe mund të shikoni dhe një foto. Një foto që
3 tregon situatën dhe kemi vendosur që të zgjedhim këtë
4 fotografi sepse nuk është e nevojshme që të shpjegohet ajo.
5 Fotografia flet vetë. Dua të them që ndërsa e shikoni këtë
6 fotografi, shihni qartë që burra, gra, fëmijë, pleq e plaka,
7 të gjithë këta njerëz kanë qenë objekt i abuzimeve të shumta,
8 përfshirë këtu edhe abuzimeve më të rënda.

9 Dhe askush nuk mund të gabojë lidhur me këtë. Unë nuk jam
10 jashtë teme, nuk jam jashtë diskutimi, por, kur përmenden këto
11 krime të tmerrshme si pjesë e kësaj procesi gjyqësor, unë,
12 personalisht, nuk kam pikë kënaqësie që t'i referohem vrasjeve
13 të asaj kohe. Sigurisht që nuk është fare kënaqësi që t'i
14 referohem përdhunimeve dhe poshtëtimeve të të gjitha llojeve,
15 të cilat ishin të shoqëruara me shkatërrim, me vjedhje, me
16 plaçkitje gjithandej, në të gjitha pjesët e Kosovës, kundër
17 popullsisë shqiptare.

18 Dua të theksoj dhe njëherë që nuk është politikë që të
19 vijohet në këtë mënyrë, sepse kjo në vetvete është vetëm një
20 kujtesë e nevojshme e të vërtetës që na ndriçon se cilat janë
21 arsyet se jemi mbledhur sot këtu në mënyrë të tillë që të
22 nisim procesin gjyqësor në çështjen kundër Shalës.

23 Pra, unë -- arsyeja pse po flas rreth këtyre krime të
24 tmerrshme është për shkak të faktit se në çështjen kundër z.
25 Shala, ne na duhet të flasim për to.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 6

1 Në fakt, askush nuk mund të kuptojë arsyet pse z. Shala
2 ishte në Shqipëri në vitin 1999, në qoftë se do të
3 konsiderohej se krimet për të cilat unë po flas nuk mund të
4 silleshin në vëmendjen tonë në çështjen që po shqyrtojmë.

5 Për më tepër, duhet të kujtohet gjithashtu që krimet e
6 kryera kundër popullsisë civile gjatë periudhës së luftës, pra
7 - në vitet 1998, 1999 - u pararendën nga vite, vite të gjata e
8 të shumta të një represioni të rëndë dhe të pamëshirë kundër
9 të gjithë popullsisë shqipfolëse.

10 Pavarësisht, në qoftë se i shikojmë apo jo, këto krime
11 atje, këto vite të tmerrshme vuajtje përbëjnë themelin e
12 fakteve që janë parashtruar përpara jush, të nderuar Gjykatës.
13 Për rrjedhojë, është e qartë për Mbrojtjen e z. Shala që këto
14 krime përbëjnë kuadrin, brenda të cilit duhet të vendosen
15 ngjarjet e mbuluara nga aktakuza.

16 Dhe për derisa gjatë këtyre deklaratave hapëse më duhet
17 të flas si avokat, ju parashtroj me respekt, të nderuar
18 Gjykatës, që këto krime për të cilat unë po flas duhet të
19 konsiderohen si histori kontekstuale, që është specifike dhe
20 që lidhet drejtpërsëdrejti me këtë çështje.

21 Kur kam qenë në Kosovë, kur isha në Kosovë jam takuar me
22 një person të mirë dhe ai më tha ca fjalë të mençura. Më tha:
23 Që ajo çfarë kemi duruar në vitin 1999 dhe në vitet më para,
24 është shumë e vështirë për t'u falur, pra, ajo çfarë ka
25 ndodhur, është e pamundur që të harrohet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 Është gjithashtu e domosdoshme të kujtohet kjo gjë sepse
2 për shkak të të gjithë këtyre viteve të abuzimeve dhe krimeve
3 të papranueshme z. Shala përzgjedhi që të bëhej pjesë e
4 rezistencës së armatosur.

5 Të nderuar Gjykatës, personi i cili është i akuzuari dhe
6 është përpara jush sot është një person që vërtetë ka bërë një
7 zgjedhje. Personi që ju do të gjykoni një ditë, në fakt, ka
8 vendosur që nuk mjaftonte. Ishte shumë për t'u duruar që ai
9 nuk mund të mbante dhe të duronte më dhunën dhe poshtërimet që
10 duhej që të kalonte dhe që duhet të kalonin dhe personat e tij
11 të dashur në të përditshmen e tyre. Pra, bëhet fjalë për vite
12 të tëra, përditë, duke duruar gjëra të tilla.

13 Për rrjedhojë, z. Shala përzgjedhi që të kundërshtonte
14 politikat kriminale dhe të luftonte ata të cilët në mënyrë
15 vullnetare dhe në mënyrë të ndërgjegjshme e ushtronin atë.

16 Kjo është e vërteta. Ky është fakti. Kjo është realja. Më
17 duhet të theksoj se asnjëherë, them edhe një herë asnjëherë,
18 nën asnjë rrethanë, z. Shala do të kishte qenë në Kukës, një
19 qytet të cilin ai nuk e njohte dhe një qytet tek i cili nuk
20 kishte pasur asnjëherë arsye për të shkuar, në qoftë se një
21 ditë nuk kishte vendosur që ishte e nevojshme dhe ishte e
22 përshtatshme që t'i rezistonte opresionit dhe shtypjes.

23 Në qoftë se z. Shala ishte në Kukës në vitin 1999, kjo ka
24 ndodhur për shkak se ai vendosi të vazhdonte të rezistonte, të
25 rezistonte shkeljet më të rënda të kryere ndaj të drejtave

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 8

1 themelore ndaj tij dhe të të gjithë atyre të cilët ai i
2 konsideronte si njerëzit e vetë.

3 Z. Pjetër Shala nuk zgjodhi që të sulmonte askënd. Ai
4 zgjodhi të luftonte, të luftonte ata që kishin përzgjedhur që
5 të përdornin dhunë në mënyrë agresive.

6 Pra, z. Shala ishte një rezistues. Duhet ta mbani
7 parasysh këtë gjë, duhet të mendoni për këtë gjë, duhet ta
8 shënoni atë. Ai ishte luftëtar i vërtetë i lirisë i cili
9 luftoi kundër agresioneve të padrejta ndaj patriotëve të tij,
10 ndaj njerëzve që në mënyrë të padrejtë ishin objekt i këtij
11 agresioni. Si rezultat, është e rëndësishme që të krijohet një
12 lidhje, pra, një lidhje shkak-pasojë ndërmjet abuzimeve të
13 kryera nga disa dhe pranisë së z. Shala në Kukës.

14 Duhet të theksohet gjithashtu natyra e kësaj lidhjeje për
15 shkak se Mbrojtja e z. Shala ka pozicionin, mban pozicionin që
16 kjo lidhje duhet të kuptohet dhe duhet të cilësohet ndërkohë
17 që ju përcaktoni lidhjen shkak-pasojë.

18 Në fakt, në qoftë se z. Shala ishte i pranishëm në Kukës
19 në vitin 1999, kjo ishte për faktin që kishte diçka shumë të
20 veçantë, jo për faktin që ai ishte kriminel, jo që ishte
21 gangster, jo që ishte kryes veprash apo që ishte delirant, nuk
22 ishte për këtë arsye apo ai nuk kishte synime për t'u sjellë
23 si persona të tillë.

24 Mbrojtja e z. Shala, për rrjedhojë, mbështet fortë faktin
25 që ai ishte i pranishëm në Kukës në vitin 1999 për arsye

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 9

1 madhore, për arsye të nderuara, të respektuara, të nderuar
2 Gjykatës. Arsye të tilla të cilat nuk kishin pikë lidhje me
3 asnjë akt apo projekt kriminal. Çdo projekt kriminal nuk
4 kishte të bënte fare me të, ishte i huaj për të por ishte dhe
5 në kundërshtim me luftën që ai kishte marrë përsipër që të
6 bënte për disa vite. Dhe për të gjitha këto vite, të gjitha
7 këto vite flasin për të.

8 Z. Shala lufton kundër disa autoriteteve dhe disa të
9 besuarve të këtyre autoriteteve në kuptimin që e zbatimit të
10 tyre të politikave kriminale. Më lejoni të shtoj, se duke e
11 bërë këtë gjë, z. Shala mbase nuk ka bërë asnjë më tepër sesa
12 ka ushtruar një prej të drejtave më të shenjta. Çfarë do të
13 thotë, të mbrojë veten dhe të mbrojë të afërmit e tij.

14 Z. Shala nuk përzgjedhi që të luftonte me popullsinë
15 serbe dhe ai asnjëherë nuk ka sulmuar një anëtar të popullsisë
16 civile serbe apo nuk ka sulmuar asnjëherë një person për shkak
17 të faktit se ishte serb. Ai nuk është kriminel.

18 Të nderuar Gjykatës, si një përfundim i parë në këto
19 deklaratë hapëse, Mbrojtja e z. Shala me respekt parashtron si
20 më poshtë, së pari, të gjithë këtu duhet të njohin historikun
21 kontekstual të përmendur më lartë dhe, së dyti, të nderuar
22 Gjykatës, ju duhet që të pranoni, të njihni burimin dhe arsyet
23 që frymëzuan vendimin e z. Shala për t'u bërë pjesë e
24 rezistencës dhe pas e luftës së armatosur kundër autoriteteve
25 shtetërore.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 10

1 Mbrojtja e z. Shala beson se këto elementë janë të
2 domosdoshëm për të kuptuar këtë çështje gjyqësore që ju është
3 parashtruar para jush, të nderuar Gjykatës.

4 Dhe le t'i sqarojmë gjërat. Mbrojtja e z. Shala nuk është
5 dakord me prezantimin e bërë nga ZPS-ja dhe nga Mbrojtësat e
6 Viktimave, pra, mënyrën sesi këto palë vendosën që ta
7 prezantonin z. Shala. Imazhi i z. Shala, portretizimi i z.
8 Shala prej tyre është fals.

9 Në këtë fazë, unë mund të them dy reflektime të cilat i
10 mendoj si shumë të rëndësishme për t'u theksuar.

11 Së pari, vetëm mund të bëj një apel të përgjithshëm për
12 të qenë të kujdesshëm. Kujdes, ju lutem, sepse me gjasa dhe me
13 sa ç'duket, kujdesi është i nevojshëm. Kam mësuar -- se
14 dëgjova dje disa gjëra shumë të çuditshme. Së pari, kolegët e
15 mi si shembull, pra, kolege nga ZPS-ja, kolegu nga Mbrojtja e
16 Viktimave foli për klimën e frikësimit të dëshmitarëve. Ju
17 lutem. Ku? Në çështjen kundër z. Shala kur ka ndodhur? Ku? Në
18 çfarë momenti? Në çfarë ngjarje? Vetëm një? Vetëm një, ju
19 lutem, na e thoni. Vetëm një. Ne presim për përgjigjen tuaj.
20 Dhe nuk ka asgjë. Dhe ju e dini këtë gjë.

21 Dhe të flasësh për klimën e përgjithshme të frikësimit,
22 në rregull, mund të flisni për këtë kur flisni për çdo gjë në
23 rastin e Kosovës, po këtu jemi specifikisht për çështjen
24 kundër z. Shala. Dhe nuk ka arsye që të përdoren prezumime nga
25 çështje të tjera ose fakte nga çështje të tjera në rastin e z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 11

1 Shala, në çështjen kundër z. Shala. Në qoftë se unë kryej një
2 gabim, ti duhet të ma thuash mua, domethënë, në qoftë se ti
3 bënë një gabim, domethënë, gabimi duhet të lidhet me personin.
4 Kështu që, në këtë rast nuk absolutisht asnjë gjë. Dosja që
5 kemi marrë që lidhet me atë çfarë quhet frikësim nga z. Shala,
6 kjo nuk qëndron. Asnjëherë nuk ndodhur.

7 Unë mendoj që nuk ka absolutisht asnjë gjurmë, asnjë
8 shenjë, asnjë pretendim që e lidh z. Shala me asnjë veprim
9 frikësues, hakmarrës. Është e rëndësishme që të thuhet kjo
10 gjë. Është e rëndësishme gjithashtu që kjo të thuhet për
11 publikun sepse publiku ka të drejtën të dijë. Të marrë vesh të
12 vërtetën, jo të dëgjojë një skenar, jo të dëgjojë diçka të
13 sajuar, një histori.

14 Së dyti, Mbrojtja e z. Shala vëren në këtë fazë atë çfarë
15 quhet një mungesë reale të informacionit rigoroz edhe
16 thelbësor që ka të bëjë me të shkuarën e Pjetër Shalës. Është
17 e çuditshme që të fillohet një çështje pa ditur asnjë
18 informacion për fëmijërinë, për vitet e tjera të mëvonshme të
19 z. Shala. Dhe kolegët e nderuar nuk thanë asgjë për historikun
20 e z. Shala, për familjen e tij, për historikun e tij. Dhe sesi
21 z. Shala u bë pjesë e UÇK-së, u kyç në UÇK, nuk dëgjuam asgjë
22 lidhur me këtë. Nuk dëgjuam asnjë germë të vetme. Asnjë fjalë
23 të vetme.

24 Sigurisht, disa gjëra të pakëndshme kanë ndodhur për të
25 shkuarën e tij, u thanë ca gjëra të pakëndshme këtu e aty, por

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 12

1 asgjë, asgjë nuk duket u tha ose nuk ishte objektive lidhur me
2 atë që nuk duhet të ishte asgjë tjetër përveçse thashetheme.
3 Përveçse fjalë.

4 Më duhet ta pranoj që jam pak i shqetësuar lidhur me
5 mënyrën e procesit gjyqësor, sikurse ju jeni dakord me mua,
6 besoj, të nderuar Gjykatës, megjithatë, për mua kjo çështje
7 penale nuk ka informacion të mjaftueshëm, është e mbështetur
8 mbi thashetheme.

9 Për më tepër, do ju kërkoja që të tregonit pak më tepër
10 modesti në këtë aspekt. Mendoj, që në veçanti, pas disa prej
11 gjërave që unë dëgjova dje, duhet të kujtojë, pra, duhet t'ju
12 kujtojë që z. Shala është dhe mbetet deri në momentin kur të
13 vendoset nga Trupi Gjyqësor në një situatë të ndryshme, pra, z.
14 Shala është tërësisht i pafajshëm, derisa ai të dënohet fajtor
15 nga Gjykata, në qoftë se kjo ndodhë.

16 Ndërkohë që ajo çfarë dëgjova dje, ishte që z. Shala i
17 vendosej gishti si fajtor për një çështje kaq të thjeshtë.
18 Pra, ky është fillimi i një procesi gjyqësor. Ju lutem. Mos e
19 harroni këtë gjë.

20 Dhe mund të them që tekstet themelore të këtyre, tekstet
21 bazë të këtyre Dhomave të nderuara kanë marrë parasysh faktin
22 e respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë. Dhe, të
23 nderuar Kryetare dhe Gjyqtarë të Trupit Gjyqësor, ju takon ju
24 detyra që të përktheni në praktikë dhe në realitet këto të
25 drejta themelore sepse ju jeni mbrojtësit dhe garantuesit e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 13

1 zbatimit dhe mishërimit të këtij parimi në seancë gjyqësore.

2 Më lejoni t'ju them të gjithë pjesëmarrësve në këtë
3 proces gjyqësor, se secili prej nesh, lidhur me rolet
4 përkatëse që ne luajmë, duhet që të respektojmë këto parime.
5 Sepse vetëm përmes respektimit të këtyre parimeve, ne marrim
6 pjesë plotësisht në vënien e drejtësisë në vend. Kështu që ju
7 lutem kini kujdes. Dëshiroj të theksoj këtë aspekt të gjërave
8 sepse që në këtë fazë mund të tregoj dhe mund të them sesa
9 problematike do të jenë deklaratat që do bëhen nga dëshmitarë
10 të caktuar dhe jam besimplotë që kolegët nga e Prokurorisë
11 janë të ndërgjegjshëm, janë në dijeni të kësaj çështjeje.

12 Dhe, në fakt, më duhet të kujtoj një realitet që nuk
13 duhet të harrohet asnjëherë në një sallë gjyqi. Edhe nën
14 përfitimin e mbrojtjeve, të të ashtuquajturave mbrojtje, një
15 dëshmitar, pavarësisht nga vuajtjet, nga tmerret që pretendon
16 që ka vuajtur, një mbrojtës, një dëshmitar i vërtetit vetëm
17 mund të kondradiktojë veten shumë pak. Kjo është më tepër e
18 vërtetë kur flitet për aspekte themelore të historisë së
19 dikujt.

20 Në qoftë se dua të mbetem i drejtë dhe transparent dhe
21 këtë dua të bëj në fakt, mua më duket dhe dua ta shtoj këtë në
22 këtë fazë, që kalimi i kohës në këtë çështje nuk është gjë e
23 mirë. Por kalimi i kohës nuk mund të shkojë deri në atë pikë
24 saqë të përdoret për të shpjeguar kundërthëniet në dëshmitë e
25 dëshmitarëve, lidhur me çështjet kyçe dhe themelore. Ju lutem.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 14

1 Vlerësimi i efektit të kalimit të kohës mbi cilësinë e provave
2 mund të përkthehet vetëm në favor të të akuzuarit dhe jo në
3 favor të dëshmitarëve në cenim të të drejtave të të akuzuarit.

4 Duhet bërë dallimi i kësaj nga vlerësimi i pasojave të
5 tjera të kalimit të kohës.

6 Pasoja e kësaj kohe të gjatë që ka kaluar mbi shpatullat
7 e z. Shala dhe Mbrojtjes, ka efektet e kohës mbi cilësinë e
8 provave që cenohen ose thjesht humben dhe mua ky pozicion më
9 duket sikur paragjykon dhe cenon z. Shala dhe mbrojtjen e tij.
10 Z. Shala, për më shumë sesa 23 vjet, nuk ka bërë asgjë që do
11 ta vendoste atë në një pozitë për të kërkuar të vërtetën ose
12 për të vërtetuar të vërtetën në mënyrë që t'i përgjigjej
13 akuzimeve dhe dyshimeve ndaj tij.

14 Në çdo rast, duhet të theksoj se nga çështja e
15 Prokurorisë, të nderuar Gjykatës ju do të merrni vesh pak ose
16 aspak lidhur me kushtet në të cilat z. Shala u bë pjesë e
17 rezistencës, e thashë këtë dhe më parë.

18 E njëjta gjë është e vërtetë lidhur me kushtet në cilat
19 ai u kyç në UÇK, pra, në ushtrinë e rezistencës, e cila,
20 sikurse na e tregon historia, ka luftuar për lirinë por, mbi
21 të gjitha, ka luftuar për mbijetesën e popullsisë shqiptare në
22 Kosovë.

23 Nuk duket sikur është pa vend në këtë fazë të procesit
24 gjyqësor të bëhet pyetja se çfarë do ishte bërë me mijëra e
25 mijëra shtetas të cilët, njerëz të cilët, u dëbuan me forcë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 15

1 nga shtëpitë e tyre dhe u dëbuan nga vendi i tyre në mënyrë të
2 dhunshme, në qoftë se UÇK-ja nuk do të kishte ekzistuar, me
3 persona të armatosur, të tillë si z. Shala.

4 Jam i sigurtë se këtu mund të them që anëtarësimi dhe
5 lufta në UÇK nuk është krim ose, për të qenë më i saktë nuk ka
6 qenë asnjëherë krim, me përjashtim se në sytë e atyre të cilët
7 në Kosovë kanë kryer disa krime që kanë qenë krimet më të
8 këqija të të drejtës ndërkombëtare, humanitare dhe penale.

9 Për më tepër lidhur me këtë temë, nuk mund të bëj më mirë
10 sesa t'i referohem qartësimi të mirëpritur dhe shkëlqyer të
11 bërë nga juridiksioni juaj në aktgjykimin e nxjerrë më 16
12 dhjetor 2022 në çështjen 05 lidhur me faktin që këto Dhoma të
13 Specializuara nuk është akuzuar asnjëherë UÇK-ja. Akuzat nuk
14 janë ndaj UÇK-së, qartësimi i një keqkuptimi në këtë rast nuk
15 ekziston më, sepse është sqaruar kjo pikë. Mendoj që ky sqarim
16 është i qartë si drita e diellit. E qartë, pra, çdo gjë e
17 qartë. Z. Shala i përkiste UÇK-së, këtë thotë dhe ai dhe ne po
18 presim që ZPS-ja të na paraqesë ato provat e të ashtuquajturës
19 përgjegjësi e madhe e z. Shala që supozohet që paska pasur
20 sipas Prokurorisë.

21 Dhe z. Shala na tha dje, po qeshte, s'po qante, "Ishte i
22 nderuar sikur Prokuroria që, në fakt, Prokuroria të më jepte
23 vërtetë meritat e këtyre titujve e emërtimeve që unë s'i kam
24 pasur ndonjëherë".

25 E vërteta është që z. Shala në vitin 1998 u plagos rëndë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 16

1 gjatë luftimeve. U detyrua të largohej nga një kundërsulm që
2 bëri ushtria dhe paraushtria serbe, që, në fakt, fatkeqësisht,
3 vranë shumë luftëtarë të UÇK-së.

4 Sikurse dhe të gjithë të mbijetuarit e tjerë të UÇK-së,
5 në zonën që ishte, nga ata që donin t'i jepnin fund apo t'i
6 përzinin këta persona, nuk kishte zgjidhje tjetër po vetëm të
7 bëhej një partner. Dhe vendosi të shkonte tek partnerja dhe në
8 atë rast partnerja ishte në Belgjikë.

9 Në Belgjikë, z. Shala nuk u përzje me politikë apo
10 aktivizëm. Nuk përfaqësoi UÇK-në dhe nuk shoqëronte ata që
11 përfaqësonin UÇK-në. Dhe nuk e bëri këtë sepse nuk pati
12 asnjëherë ato përgjegjësi që duan kaq shumë t'ua japin këta
13 persona sot. *Ubi nihil, nihil*. Janë fjalë romake. Të vështira
14 për t'u përkthyer, kuptohet. S'ka asgjë, pra, asgjë. Nuk ka
15 kurrfarë përgjegjësie z. Shala. Ai e respekton ligjin e këtij
16 vendi që e pranojnë dhe atje zbuloi se çfarë ishte një jetë
17 normale në këtë shtet. Mund të dilte mbrëmjeve pa pasur frikë
18 se mos e arrestonin dhe se mos e rrihnin për të vetmen arsye
19 se fliste shqip. Për të ishte e mrekullueshme kjo. Diçka e re.
20 Mund të punonte, të fitonte jetesën dhe kjo ishte një gjë e re
21 për të dhe këtë mund ta bënte pa pasur frikë nga policia dhe
22 milicia dhe kjo ishte e pabesueshme për të. Belgjika për të
23 dukej një formë, një lloj parajse.

24 Ai po përpiqet të marri statusin e azilit politik dhe për
25 ta bërë këtë, ai, si shumë të tjerë në situatën e tij,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 17

1 gënjejnë pak ose përpiqen të përmirësojnë pak të dhënat e
2 veta. Por është e qartë ama që as ZPS-ja nuk mund t'i kthejë
3 këto gënjeshtër të nevojshme në një të vërtetë të vërtetuar,
4 të provuar pra.

5 Dhe kështu dolën imazhet dhe lajmet, për këto krimet që
6 po kryheshin gjerësisht në Kosovë kundër personave. Jemi në
7 mars të 1999, po flasim për marsin e 1999.

8 Kështu duke dëgjuar, domethënë, dëgjoi zëra, dëgjoi --
9 ndjeu detyrën që të largohet dhe ta linte parajsën, Belgjikën
10 dhe të kthehet në ferr, vërtetë në ferr, siç ishte aso kohe në
11 Kosovë. Ai nuk kërkon falënderime apo merita për këtë. Nuk
12 mund të kishte vepruar ndryshe. Ishte e paimagjinueshme për të
13 të qëndronte atje ku ishte, në Belgjikë pra, ndërkohë që kaq
14 shumë njerëz po vuanin.

15 Kështu që u largua bashkë me disa të tjerë që po ashtu
16 kishin zgjedhur të ktheheshin të luftonin e të mbronin ata që
17 i kishin mbijetuar. I kishin mbijetuar shkatërrimit të
18 banesave të tyre, të fshatrave të tyre, të familjeve të tyre.
19 Ky është realiteti. Z. Shala nuk është mostër. As nuk po them
20 që është hero. Është thjesht një njeri.

21 Dhe kështu përfundoi z. Shala në Durrës, Durrës, Shqipëri
22 dhe këtu fillon skenari i plotë i projektuar nga ZPS-ja, gjatë
23 këtij gjykimi ZPS-ja do përpiqet që të tregojë.

24 Çfarë ndodhi në Durrës? Sipas skenarit të Prokurorit, se
25 ky është skenari real, ne nuk e dimë. S'kemi marrë ndonjë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 18

1 informacion nga Prokuroria dhe më vjen keq ta them, të nderuar
2 Gjykatës, as ju nuk e dini. Kjo është zgjedhja e Prokurorisë.
3 Ne nuk morëm asgjë, nuk kemi marrë asgjë dhe madje unë nuk e
4 di nëse dhe hetuesit i kanë shqyrtuar ndonjëherë këto
5 informacione.

6 Por ajo që kuptojmë ne nga pretendimet e Prokurorisë
7 kundër z. Shala është kjo: Që ai shkoi në Kukës, nga Durrësi,
8 për të komanduar dhe për të pasur kontrollin e fabrikës së
9 metalit në Kukës si pjesë e rolit të tij si shef i Brigadës
10 128 të vendosur në Kukës. Por, të nderuar Gjykatës, nuk është
11 ky realiteti.

12 Realiteti është, nëse shikojmë shkresurat në dosje,
13 sidomos ato që vijnë nga hetimet e vetë ZPS-së, është që z.
14 Shala, që donte të shkonte në frontin e luftës e të luftonte
15 kundër atyre që po përzinin të pafajshmit nga vendi i tyre, z.
16 Shala shumë shpejt e mori vesh që nuk kishte ndonjë pozitë për
17 atë në Kukës. Asnjë lloj pozite. Realiteti është z. Shala
18 besohet se u dërgua në zonën operative të Pashtrikut, pra, në
19 Kukës, ku ishte dhe pika ku po ndodhnin luftimet mes
20 luftëtarëve të rinj, pra, pika ku takoheshin luftëtarët e rinj
21 dhe civilët që donin të kyçeshin në UÇK.

22 Nuk shkoi me ndonjë gëzim të madh atje, por shkoi atje
23 sepse ishte më afër frontit, pranë kufirit dhe thellë-thellë,
24 beson se nuk kishte zgjedhje tjetër.

25 Kur shkoi atje zbuloi se ekzistonin tri organizata të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 19

1 ndryshme apo struktura, nëse dëshironi t'i quajmë kështu. Pra,
2 tre grupe të ndryshme që qëndronin në një fabrikë të vjetër
3 ose afër kësaj fabrike.

4 Një qendër e rëndësishme logjistike në këtë fabrikën e
5 metalit; dhe, ishte qendra më e madhe e mobilizimit të UÇK-së
6 në këtë fabrikën e metalit; dhe, një grup ushtarësh që janë
7 angazhuar që të ndërtonin një brigadë, të krijonin një
8 brigadë. Dhe kjo ishte afër, afër, afër rrethinave të fabrikës
9 së metalit. Nëse vendosni të shkoni atje do të shihni, ta
10 shihni vendin, vendet e ndryshme ku është përpjekur z. Shala
11 që të gjente një vend për veten e tij. S'kishte asnjë vend për
12 të. Nuk gjeti asnjë vend.

13 Shumë shpejt, z. Shala e kuptoi që askush s'e priste atje
14 dhe se nuk kishte vend për të në asnjë nga këto organizata.

15 Fatmirësisht, ai njohu -- njihte administratorin kryesor
16 të këtij grupi logjistik në këtë fabrikën e vjetër dhe hyri në
17 kontakt me të. Na u desh -- do ta vërtetojmë ne këtë.

18 Dëshira e tij ishte që të bëhej pjesë e frontit, të
19 luftonte, e pyeti këtë oficer, që e njihte si veteran, i
20 kërkoi t'i jepte një armë në mënyrë që të bashkohej me
21 luftëtarët në kufi dhe të luftonte në front.

22 Ne e dimë se kështu ai mori një armë dhe sesi u largua
23 nga Kukësi dhe nga fabrika e vjetër pa marrë ndonjëherë ndonjë
24 formë përgjegjësie, pa pasur ndonjëherë ndonjë përgjegjësi apo
25 ndonjë rol atje.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 20

1 Ai qëndroi në front, ose diku aty afër, herë pas here
2 bashkohej me disa luftëtarë ose në kampet e UÇK-së që të
3 pushonte, të merrte veten dhe të vazhdonte përsëri të
4 luftëtonte, të luftonte në këto kushte të jashtëzakonshme, në
5 këto rrethana të jashtëzakonshme edhe ishte në atë kohë,
6 ekzistonte, një ç'organizim i jashtëzakonshëm.

7 Dhe kjo është e rëndësishme për t'u thënë. Të gjithë ne e
8 dimë, ne kemi parë dhe transmetime të televizor, kemi lexuar
9 dhe libra, ka qenë një nga vështirësitë më të mëdha për UÇK-në
10 kjo gjë, të organizonin luftëtarët. Shumë grupe vepronin si
11 elektrone të lirë. Luftëtarët apo grupet e luftëtarëve tamam
12 silleshin si elektrone të lirë dhe kjo ishte krejt normale,
13 ishte një nga vështirësitë organizative të UÇK-së që t'i
14 bindte, t'i gruponte në këto kohë kaq të pasigurta dhe kaq të
15 vështira.

16 Kështu z. Shala thjesht kaloi kalimthi në fabrikën e
17 metalit në Kukës dhe absolutisht nuk u stacionua atje. Mund të
18 ketë kaluar disa net këtu-aty sepse ishte një vend i
19 pakëndshëm, s'kishte zhvillim. Të gjithë po të shkojnë atje e
20 kuptojnë këtë gjë. Të gjithë personat atje kalojnë, pranonin
21 disa njerëz nëpër depo, grupet e logjistikës kryesisht edhe
22 oficerët dhe synimi ishte qendra e mobilizimit. Ishte një vend
23 i pakëndshëm. Ju thashë vetëm depo kishte atje edhe një
24 kuzhinë ku mund të haje. Por as konvikt nuk kishte, fjetore
25 nuk kishte. Ju e keni parë. S'ka fjetore atje. Dhe ne e dimë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 21

1 këtë nga fakti që personat e UÇK-së flinin, ishin të detyruar
2 të flinin mbi dysHEME prej betoni.

3 Dhe z. Shala mohon në mënyrë kategorike të këtë qenë
4 ndonjëherë anëtarë i Brigadës 128. Kështu që lidhjet e tij me
5 fabrikën e metalit në Kukës janë thuhetse jo ekzistente.

6 Dje pamë prezantimet tredimensionale të ZPS-së. Urime për
7 këto imazhe. Po ka një por ama, më vjen keq. Por, besoj, për
8 një person që s'e ka vizituar asnjëherë fabrikën e metalit të
9 vjetër, gjëja më interesante që nuk u përfaqësua këtu, është
10 brenda ndërtesë, ambienti brenda, nuk na u tregua asgjë si
11 ishte brenda kjo ndërtesë. Dhe ne do të donim që ju ta shihnit
12 në fakt, sigurisht. Në këto dhoma të famshme apo zyra, të
13 shihnim saktësisht si ishte planimetria e brendshme, përmasat
14 e këtyre dhomave, gjendja e këtyre dhomave, ambienteve. Dhe
15 tani atje janë plaçkat siç kanë qenë, mobiliet.

16 Dhe kur lexoj deklarata të personave që pretendojnë që
17 kanë qenë viktime atje, kam idenë dhe më krijohet përshtypja
18 se është e pamundur që të kenë qenë kaq shumë persona në këtë
19 dhomë. Tetë, nëntë, dhjetë, 12, s'ka rëndësi, në varësi të
20 deklaratave, sepse kemi shumë ndryshime. Dhe doja të dija, me
21 të vërtetë dhe shpresojmë t'i shohim versionin e këtyre
22 sallave çfarë, si ishin këto salla.

23 Prandaj është e rëndësishme që të bëhet një vlerësim i
24 provave që ju keni.

25 E njëjta gjë për këtë praninë e pretenduar të një burgu

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 22

1 në fabrikën e metalit në Kukës. Z. Shala mori vesh për këto
2 akuza, pretendime, vetëm gjatë hetimeve. Z. Shala as ka parë
3 ndonjëherë, as ka ditur ndonjëherë gjë për ekzistencën e një
4 burgu në fabrikën e metalit dhe as nuk ka parë gjë që do ta
5 nxiste të besonte apo të kuptonte se atje mund të ekzistonte
6 një burg i tillë. Dhe ju e dini, krahas kësaj, ai ka thënë që
7 asnjëherë nuk ka marrë pjesë në ndonjë marrje në pyetje apo të
8 ketë marrë pjesë në ndonjë torturë të asnjë lloji. Sigurisht,
9 të nderuar kolegë, këto pres që t'i dëgjoj nga ZPS-ja. Z.
10 Shala, i mohon akuzat edhe fakti që i mohon kërkon që duhet
11 parë me të vërtetë fajësia e tij në këtë situatë.

12 Z. Shala, nuk është i vetmi që i bënë këto deklaratë. Kjo
13 nuk është deklaratë e z. Shala. Në të gjitha këto tema, pra,
14 lidhur me këto pika - më falni- pjesa më e madhe e personave
15 që ka intervistuar vetë ZPS-ja thonë të njëjtën gjë, i
16 qëndrojnë të njëjtës deklaratë. Dhe ZPS-ja ka intervistuar
17 shumë persona që kanë kaluar kohë në fabrikën e metalit në
18 Kukës apo në Brigadën 128 dhe më duhet të them se me sa duket
19 shumica e këtyre dëshmitarëve, shumicën e të cilëve ZPS-ja ka
20 vendosur të mos i thërrasë për të dhënë dëshmi, thjesht,
21 kundërshtojnë pretendimet e Prokurorisë.

22 Personat e vendosur në fabrikën e metalit në Kukës sepse
23 po merreshin me pjesën e logjistikës apo të mobilizimit thonë
24 që nuk e njohim Pjetër Shalën. Nuk njohin asnjë person që
25 thirrej Ujku, ose e kanë parë shumë rrallë atje. Shumica e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 23

1 këtyre personave, biles shumica e personave nga Brigada 128 e
2 konfirmojnë këtë dhe konfirmojnë faktin që Pjetër Shala nuk ka
3 qenë anëtar i kësaj brigade, asnjëherë s'ka qenë anëtar i
4 kësaj brigade. Këta njerëz do ta kishin njohur Pjetër Shalën
5 ose do ta kishin parë sikur të kishte qenë anëtar i kësaj
6 brigade, sigurisht.

7 Shumica, unë them shumica, them shumica e personave që ka
8 intervistuar ZPS-ja nuk e konfirmuan dhe as nuk e mohuan në
9 mënyrë kategorike ekzistencën e një burgu brenda fabrikës. As
10 konfirmuan, as e mohuan. Pra, s'e konfirmuan dhe as e mohuan,
11 e përsëris. Nëse i pyesin dhe kur t'i pyesin, këta persona
12 mohojnë që të jenë marrë në pyetje persona e jo më pastaj të
13 jenë rrahur brenda zyrave apo ndërtesës apo kudo në ambientet
14 e kësaj fabrike.

15 Ne nuk e dimë cili ishte realiteti, por një gjë është e
16 sigurtë, kjo tregon të paktën një gjë. Ekzistencën, praninë
17 dhe funksionimin e një burgu, tregon pra, që ekzistenca e një
18 burgu në fabrikën e metalit nuk ishte e dukshme. Dhe deklarata
19 e z. Shala lidhur me këtë është tërësisht e besueshme. Nuk ka
20 gjë. Nuk ka këtu gjë. Nuk ka arsye për ta vënë në dyshim. Kjo
21 është një nga vështirësitë më të mëdha që do të kemi,
22 domethënë, në çështjen tonë, që ta vërtetojmë këtë.

23 Këta persona konfirmojnë që ishte një bazë logjistike në
24 fabrikën e metalit ku merreshin, pra, ku kalonin qindra
25 ushtarë që kalonin atje çdo ditë. Kalonin për arsye mobilizimi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 24

1 dhe të dërgonin në front më pas. Sa prej këtyre dëshmitarëve
2 të drejtpërdrejtë do të shfaqen, do të paraqiten në Gjykatë,
3 në seanca? Asnjë. Asnjë.

4 Fabrika e metalit në Kukës ishte e mbyllur gjatë natës,
5 ne këtë e dimë, të gjithë e dimë këtë gjë. Dhe ndërtesa e
6 oficerëve ishte një ambient ku ushtarët dhe oficerët flinin në
7 kushte minimale jetike. Do ta vërtetojmë këtë. Marrja në
8 pyetje dhe rrahja e personave në ambientin ku flinin
9 ushtarakët dhe shqiptarët është absolutisht e pavërtetë,
10 sidomos, siç pretendohet, që thonë pastaj ka ndodhur çdo natë,
11 gjatë gjithë natës, për javë të tëra.

12 Të gjithë këta persona që janë intervistuar konfirmojnë
13 përmes dëshmive të tyre se nuk kishte vend për z. Shala atje
14 dhe s'e nuk ishte Shala në atë vend.

15 Ky është realiteti që ZPS-ja ka marrë duke pyetur rreth
16 fabrikës së metalit në Kukës dhe ky është realiteti që përdor
17 ZPS-ja për të ngritur akuza kundër z. Shala. Në fakt, ka të
18 ngjarë që kjo të jetë edhe arsyeja pse ZPS-ja ka zgjedhur të
19 mos i përdorë këto dëshmi, madje ndonjëherë i ka tërhequr, e
20 ka tërhequr pasi ka bërë me dije se do ta përdorte këtë provë.
21 ZPS-ja madje ka tërhequr dhe mundësinë e vetme që ju, të
22 nderuar Gjykatës, të dëgjoni dëshmitë e një dëshmitari që ka
23 pamje filmike të realitetit të fabrikës së metalit në Kukës
24 për periudhën e paraqitur në aktakuzë. Kjo tregon diçka, të
25 nderuar Gjykatës. ZPS-ja shkon më tej me akuzat kundër z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 25

1 Shala edhe në gamën e këtyre provave kontradiktore që vetë i
2 ka mbledhur. ZPS-ja shkon më tej me akuzat e veta, me
3 pretendimet kundër z. Shala, kundër realitetit, që në fakt
4 janë kundër realitetit.

5 Megjithatë, dje edhe njëherë, prokurorët e ndryshuan
6 çështjen e tyre. Tani, z. Shala nuk është më i pranishëm gjatë
7 gjithë kohës. Papritmas kështu. Dje e dëgjuam për herë të parë
8 këtë. Është gjë e re për ne. Autoriteti dhe roli i tij në
9 fabrikën e metalit në Kukës është i ri, pra, nxorën diçka të
10 re dje. S'e kishim dëgjuar ndonjëherë. U zbeh, pra, roli që
11 kishte bërë ai.

12 Po kështu ZPS-ja iu afrua një çik më shumë realitetit,
13 por ende ka shumë punë, sepse ZPS-ja ka dhënë parashtrime
14 kontradiktore kur pretendoi se z. Shala nuk ishte i stacionuar
15 atje por sidoqoftë mori pjesë në të paktën 10 incidente që
16 përfshinë rrahje në 14 ditë. Dhjetë në 14 ditë. Këtë thatë?
17 Nëse s'e kam kuptuar më ndërprisni ju lutem.

18 Dhe, madje dhe më shumë se kaq, dje ZPS-ja pretendoi se
19 z. Shala ka marrë pjesë në incidentin e jelekut antiplumb kur
20 e kishin tërhequr këtë pretendim në aktakuzë.

21 Shprehimisht dhe kur them "kontradiktore", "të paqarta",
22 të paqarta janë, po besoj se do t'i kuptojmë në momentin që do
23 vijë koha e duhur për t'i kuptuar.

24 Kjo çudi që dëgjuam dje nuk është e vetmja. E një edhe
25 për viktimën e pretenduar në këtë çështje. Me përjashtim të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 26

1 një personi specifik që e njihte shumë kohë përpara luftës së
2 1999, z. Shala po ashtu u habit shumë kur dëgjoi dhe lexoi që
3 paska qenë pjesë e një grupi që ka ndaluar dhe ka rrahur disa
4 persona sepse, në fakt, s'i ka takuar ndonjëherë këta persona.
5 Duhet të kuptoni, është e habitshme kjo, të pranosh këtë
6 dëshmitarin që ai e njeh prej shumë vitesh. Kemi dy persona që
7 e njohin z. Shala në fakt. Më falni, që pretendojnë që thonë
8 që z. Shala i ka ndaluar, i ka rrahur, po ata nuk e njihnin
9 atë. E habitshme është kjo.

10 Madje më shumë e habitshme për z. Shala ishte kur zbuluan
11 llojin e personalitetit dhe të karakterit të këtij të njohurit
12 të vjetër dhe me se çfarë merrej ky person që para luftës e
13 deri tani që flasim. [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]s'ka gjë u zhduk.

9 S'ka më hetime. Po ky dëshmitari, ky dëshmitari po vjen këtu
10 të na shpjegojë ne, të na bind ne, për gjërat që ai beson.

11 Situatë e veçantë kjo. Në këtë procedurë për mua është
12 vërtetë -- ka një pikëpyetje kjo situatë. Është çik shpejtë,
13 sigurisht. S'është dita, s'është vendi sot. Dhe do të jetë
14 shumë e vështirë për shkak të kësaj, por sidomos kjo pjesë për
15 z. Shala që është konfidenciale. Mbresëlënëse, kërkon të
16 vërtetën, përpiqesh të bësh një gjyq të thuash po, po, e pamë
17 realitetin por jo të gjithë. Ju lutemi. Se ca gjëra janë
18 konfidenciale.

19 Pra, çudia e z. Shala kur mësuam që ishte kishte të bënte
20 apo e përshkroi si mostër, si përbindësh, në fakt, zhduket kur
21 shikohet, kur thuhet që është një dëshmitar që thotë që e njeh
22 z. Shala.

23 Faleminderit kjo është një fotografi konfidenciale, të
24 nderuar Gjykatës. Dhe ta shohim këtë dokument -- po ky është
25 dokumenti që kërkojmë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 28

1 Shikoni se ç'punë të mrekullueshme kanë bërë hetuesit.
2 Nuk e kemi parë këtë më parë. U tregojnë njerëzve emrin e një
3 personi me Ujku aty në armë. Dhe kur thotë që ky është z.
4 Shala. Dhe të gjithë e dinë që kjo nuk është e vërtetë. Të
5 gjithë e dinë. Kjo nuk është fotografi e të akuzuarit. Dhe kjo
6 çudi hiqet kur shikon përshkrimin që jepet kur kërkohet lidhur
7 me z. Shala. Dhe ky është dokumenti i tretë që dua t'ju tregoj
8 juve, të nderuar Gjykatës.

9 E para më duket. Po, po. Kjo është. Po. Faleminderit.

10 Ky është përshkrimi që ka dalë nga dëshmitari. Numrin e
11 të cilit e përmendën disa herë kolegët e mi të nderuar. Dhe
12 lexoni këtë përshkrimin që bëhet për z. Shala. Dhe kjo është
13 shumë e çuditshme. Është një nga gjërat më të çuditshme që
14 shihen. Dhe kjo nuk ka të bëjë fare me tiparet e të akuzuarit.
15 Dhe kjo është cilësia e dëshmitarëve që kanë ardhur si
16 rezultat i hetimeve nga/dhe të ZPS-së. Dhe e di që po përsëris
17 veten por, në qoftë se nuk doni të bëni -- për të mos bërë
18 gabim, duhen përsëritur.

19 Janë tre të akuzuarit që kanë -- tre personat që kanë
20 akuzuar z. Shala. Dhe ai personi në fotografi, nuk njihet si i
21 tillë. Dhe kur jeni të vendosur në çengel apo në kurth,
22 atëherë do të mund të ta gjeni një gjë, por, në fakt, ka
23 mjaftë raste të kësaj natyre. E dimë këtë nga Lufta e Dytë
24 Botërore. Është një fotografi e një personi i cili e ka
25 trilluar një gjë të tillë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 29

1 Nga ana tjetër personat që ZPS-ja thotë që janë ndaluar
2 në fabrikën e metaleve në Kukës nuk flasin fare për z. Shala
3 apo për Ujkun. Ata nuk e identifikojnë në fotografi z. Shala
4 dhe, në fakt, nuk e dinë fare emrin Pjetër Shala apo nofkën e
5 tij, nofkën Ujku.

6 Është e njëjta gjë, nëse unë bëj gabim më ndërprisni. Nuk
7 kam ardhur unë këtu për të trilluar gjëra.

8 Të nderuar Gjykatës, duket se disa persona që ZPS-ja
9 thotë që janë ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës e mohojnë
10 një gjë të tillë, e kanë mohuar një gjë të tillë.

11 Por, megjithatë një çudi nuk është zhdukur ende deri më
12 sot dhe është mungesa e cilësisë së hetimeve të kësaj
13 çështjeje.

14 Hetimet e mëparshme që ka marrë nga hetuesit e mëparshëm
15 ZPS-ja si dhe hetimet e mëtejshme që kanë bërë vetë zyra e
16 ZPS-së kanë konfirmuar se realiteti është i ndryshëm.

17 Por ZPS-ja ka bërë zgjedhje të çuditshme duke paraqitur
18 akuza kundër z. Shala pavarësisht gjithë kësaj. Për ta bërë
19 një gjë të tillë, ai ka bërë atë që unë e përshkrova si më
20 parë - po t'ju kujtohet - që ka zgjedhur dëshmitë më të mira
21 që t'u shërbejnë argumenteve të tyre. Dhe duke e bërë një gjë
22 të tillë i ka lënë mënjanë të gjithë dëshmitë kundërshtuese,
23 që ishin të një vëllimi shumë më të madh.

24 Pra, shqetësimi ynë dhe qortimet që i kemi për këtë hetim
25 nuk janë të kufizuara në ato që ka bërë ZPS-ja por edhe ato të

1 cilat u kanë paraprirë atyre.

2 Së pari, ato hetime të cilat kishin në qendër të
3 vëmendjes të ashtuquajturin trafikim të organeve. Nga leximi i
4 materialeve që janë nxjerrë Mbrojtjes, është e qartë se
5 objektivi ishte për të nxjerrë akuza kundër personaliteteve të
6 nivelit të lartë të UÇK-së, por për ta bërë këtë mbi bazën e
7 dëshmive shumë të dyshueshme nga individë të cilët vinin nga
8 sfera e krimit të organizuar dhe trafikut të drogës. Kjo ishte
9 kaq e pavërtetë, jorealiste, e fantazuar sa që vetë hetuesit e
10 vendosën të mos e ndjekin më tej.

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]. E kanë

4 bërë më të qartë mungesën e besueshmërisë së disa provave dhe
5 kanë nxjerrë në pah kontradiktat e dukshme dhe të pavërtetat e
6 pathemelta të bëra nga disa dëshmitarë të cilët i ndryshojnë
7 rrëfimet e tyre në bazë të fakteve të reja që dalin në dritë.

8 Dhe është e çuditshme që shohim sesi gjatë gjithë këtyre
9 hetimeve dëshmitarët ndryshojnë rrëfimet e tyre dhe i
10 ndryshojnë në thelb. Dhe është e çuditshme që deklaratat e
11 tyre ndryshojnë në bazë të rezultateve të hetimeve të
12 mëvonshme. Si është e mundur që në të njëjtën kohë sapo del
13 një element i ri gjatë një hetimi, ata dëshmitarë papritur
14 kujtohen dhe ndryshojnë deklaratat e tyre?

15 Ky është problem. Këta dëshmitarë i kanë përshtatur
16 deklaratat e tyre pa problem. Çfarë hetimi është ky? Dhe unë e
17 di që këtu bëhet fjalë për hetues profesionistë. Po çfarë
18 lloji hetuesish janë këta?

19 Do të shihni të njëjtën gjë, sesi ky dëshmitar i famshëm
20 i jep informacione të reja hetuesve profesionistë, kur është
21 pyetur: Pse e keni ndryshuar? A mund ta shpjegoni? Dhe
22 përgjigja ka qenë e njëjtë gjatë gjithë kohës: Kam marrë këtë
23 informacion, kam emrin e personit, i cili ma ka dhënë
24 informacionin. Kam marrë një dokument të ri, ma kanë sjellë në
25 shtëpi. Do t'ua sjell juve.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 32

1 Por, asnjëherë nuk ka ndodhur që këta hetues t'i marrin
2 këto dokumente, emra, burime apo të bëjnë vlerësimin e
3 deklaratës apo ndryshimet e deklaratës së dëshmitarit. Kjo
4 është e çuditshme.

5 Po të mos ishte çështje penale, do të duhet të qeshnim.
6 Që hetuesit nuk pyesin për herë të dytë apo të tretë apo nuk
7 kërkojnë që ta marrin këtë informacion. Nuk ishin të
8 interesuar. Dhe kjo është gjë shumë e çuditshme gjatë një
9 gjykimi. Pasi cilësia e provave në periudhën paragjyqësore nuk
10 është e njëjtë si në periudhën e gjykimit.

11 Dhe, e fundit, qortimet tona lidhur me hetimet kanë të
12 bëjnë me zgjedhjet që ka bërë vetë ZPS-ja. ZPS-ja ka kërkuar
13 me çdo kusht që t'i jepte besim, t'i krijonte, të vërtetonte
14 dhe t'i jepte besimin e plotë skenarit që kanë zgjedhur duke
15 injoruar një numër elementësh ekzistuese dhe pamundësinë për
16 t'i eksploruar ato. Çdo element prove i cili kundërshton apo
17 dobëson skenarin që kanë zgjedhur për të fajësuar z. Shala
18 është hedhur tutje, është hedhur mënjanë dhe pa arsye të
19 qëndrueshme.

20 Unë mendoj që kjo është e pashpjegueshme dhe e
21 papranueshme kur bëhet fjalë për gjetjen e së vërtetës.

22 Dhe kur shohim që -- dhe kur ZPS-ja ngre këtë çështje
23 problematike kundër z. Shala, do t'i shkojë më tutje dhe kjo
24 ishte dhe më e pabesueshme. Dhe duan të dalin edhe jashtë
25 periudhës së aktakuzës dhe ZPS-ja po kërkojnë - dhe po them po

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 33

1 kërkojnë, po peshkojnë - të gjejnë, si të thuash,
2 dokumentacion dhe prova të cilat janë të bazuara mbi
3 thashetheme të vitit 1998. Kur ne po flasim për faktet që
4 thuhet që janë bërë në vitin 1999. Të nderuar Gjykatës do ta
5 mbani parasysh që kjo është bërë në fazat e fundit të
6 periudhës paraprake.

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 Z. Shala ka marrë fletë-thirrje dhe ka shpjeguar veten
15 përpara TPNJ-së pa pasur nevojë që të arrestohej. Arrestimi i
16 z. Shala është një çështje shumë e rëndë. Kur arritën hetuesit
17 dhe policia për ta arrestuar z. Shala, ata nuk kishin nevojë
18 të merrje ndonjë rrezik. Por mënyra si u bë kjo gjë ishte e
19 tmerrshme.

20 I kërkoj ndjesë, z. Shala, unë do të them që vajza,
21 djali, gruaja e tij duhet të shkojnë tek mjeku, tek psikologët
22 edhe tani gruaja e z. Shala nuk është në gjendje të punojë për
23 shkak të asaj ngjarjeje. Ka pasur më shumë persona që janë
24 dërguar për të arrestuar z. Shala sesa Bin Laden, sesa numri i
25 personave që kanë çuar autoritetet e Shteteve të Bashkuara për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë private)

Faqe 34

1 të arrestuar Bin Laden dhe më pastaj për ta vrarë atë. Është
2 një armatë e tërë. Njerëz të armatosur gjitha ata. Por dakord,
3 nuk është nevoja që të dëmtohen njerëzit e pafajshëm. Gruaja
4 dhe fëmijët e z. Shala.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
6 Avokat, desha të kalojmë në seancë të mbyllur për dy minuta.
7 Znj. Sekretare, a mund të na kalojmë në seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 tani jemi në seancë publike.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Vazhdoni.

11 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit, të
12 nderuar Gjykatës.

13 Pra, kjo periudhë e 1998, është periudha kur hetuesit e
14 TPNJ-së e ka hetuar këtë situatë dhe kanë krijuar, si të
15 thuash dhe kanë pasur fotografinë e z. Shala në atë kohë.

16 Dhe dua të paraqesin në ekrane këtë fotografi të re.
17 Faleminderit.

18 Edhe këtu, shikoni këtë fotografi në mënyrë konfidenciale
19 me qëllim që -- dhe këtu bëhet fjalë për fotografinë numër 2,
20 as nuk ka afërsi apo ngjashmëri me z. Shala. Dhe e di pse, të
21 nderuar Gjykatës? Pasi dëshmitarë të mbrojtur ende thonë që ky
22 është z. Shala, Ujku.

23 Edhe njëherë. Kjo është një lloj prove që është në
24 kundërshtim me çdo gjë.

25 Do të dëgjoni, të nderuar Gjykatës, që mbiemri Shala nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 36

1 është i vetëm në Kosovë dhe në Shqipëri por është shumë i
2 përhapur. Do të dëgjoni po kështu që nofka "Ujku" është
3 përdorur gjerësisht nga luftëtarë shqiptarë dhe këtë e shihni
4 në dokumentin që na ka dhënë vetë ZPS-ja. E kemi parë mjaft,
5 një numër të variantesh të tij, Ujku, Uki, Uka, Ukaj, Vuk e
6 kështu me radhë, që i kanë përdorur nga persona të tjerë.

7 Ujku, është shfrytëzuar nga një numër i këtyre
8 luftëtarëve, por kemi parë që një numër prej këtyre
9 luftëtarëve të cilët janë në dosjet e Prokurorisë dhe një
10 shembujt më të mirë është Ujku, statuja e të cilit është
11 vendosur në qendër të Prishtinës në rrugën Nenë Tereza. Dhe,
12 sigurisht, që ky Ujku nuk është Pjetër Shala. Dhe kjo dihet
13 publikisht.

14 Si përmbledhje, të nderuar Gjykatës, një çështje
15 gjyqësore nuk mund të ndërtohet bazuar mbi thashetheme.
16 Fajësia e një të akuzuari të ngarkuar me vepra penale duhet të
17 provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe kjo nënkupton që të
18 ekzistojnë elementë të fuqishme të provës të cilat mund të
19 eliminojnë të gjithë skenarët alternativë të arsyeshëm. Një
20 vepra penale apo akuzë penale e kësaj natyre duhet të provohet
21 me dëshmi të dorës së parë që vijnë nga njerëz që kanë
22 njohurinë e duhur, që kanë qenë atje dhe e dinë sesi ka qenë
23 realiteti. Është shumë e thjeshtë. Por nuk bëhet duke lënë
24 mënjane dëshmitë përkatëse apo duke shfrytëzuar thashetheme
25 periferike që vijnë nga burime të dyshueshme apo nga njerëz të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata hyrëse e Mbrojtjes (Seancë e hapur)

Faqe 37

1 cilët i kanë ndryshuar rrëfimet e tyre disa herë, shumë,
2 shumë, shumë herë.

3 Të nderuar Gjykatës, që nga fillimi i këtij gjyqi, ne
4 kemi zgjedhur apo jemi përpjekur që të zgjedhim të jemi të
5 qartë dhe të hapur në qëndrimet tona dhe ne do të vazhdojmë ta
6 bëjmë një gjë të tillë. Ne mund të kishim qëndruar në heshtje,
7 ne nuk kërkuam që të dorëzonim një dosje paraprake dhe asnjë
8 deklaratë hyrëse. Z. Shala mund të kishte zgjedhur po kështu
9 që të mos e bënte deklaratën e tij pa betim. Po kështu, ne
10 mund ta kishim vonuar qëndrimin tonë deri pas përfundimit të
11 argumenteve të ZPS-së. Por ne nuk kemi asnjë, absolutisht,
12 asgjë për fshehur, të nderuar Gjykatës.

13 Për shkak se Mbrojtja e z. Shala dhe vetë z. Shala duan
14 të kërkojnë të dalë e vërteta, për shkak se ne besojmë
15 thelbësisht që realiteti dhe e vërteta janë ato të cilët do të
16 japin drejtësi z. Shala,

17 Dhe, si përfundim i kësaj deklarate hyrëse, dua të
18 riafirmoj, besimin tim, që së bashku, ne të gjithë, do ta
19 gjejmë të vërtetën.

20 Ju falënderoj për kohën dhe për vëmendjen, të nderuar
21 Gjykatës. Dhe me lejen tuaj, tani është momenti që z. Shala të
22 thotë disa fjalë të tija.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit.

25 Avokati Mbrojtës, a mund të na tregoni sesa kohë mendon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 38

1 z. Shala që i duhet për deklaratën e tij pa betim?

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Unë besoj që z. Shala do të flasë
3 për maksimumi pesë minuta. Ju falënderoj.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Dakord. E kuptoj.

6 Atëhere, tani do të marrim pushimin prej gjysëm ore dhe
7 më pas do të dëgjojmë deklaratën pa betim të z. Shala. Dhe më
8 pas do të diskutojmë diçka që ka mbetur nga dita e djeshme për
9 sa u përket dy ditëve gjatë të cilave mund të dëgjojmë
10 dëshmitarë.

11 Tani marrim pushimin.

12 Kur të kthehemi, z. Shala, do të keni mundësinë të jepni
13 deklaratën tuaj pa betim.

14 Tani marrim pushimin.

15 --- Pauza fillon në orën 10.54

16 --- Seanca rifillon në orën 11.25

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
18 se vini sërish.

19 Po shikoj rreth e rrotull.

20 Dhe shikoj përbërjen. Dhe shikoj që të njëjtët persona
21 janë tek ZPS-ja.

22 E njëjta gjë edhe për Mbrojtësin e Viktimave.

23 Dhe po kështu edhe ju nga ana e Palës Mbrojtëse.

24 Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

25 Kemi një ndryshim të vogël në përbërjen tonë. Judit Kolbe nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata pa betim e Pjetër Shalës (Seancë e hapur)

Faqe 39

1 është e pranishme këtu, por një stazhiere tjetër nga Parisi,
2 znj. Camille Gosson është këtu me ne sot.

3 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Tani do të vazhdojmë me deklaratën pa betim të z. Shala.

7 Z. Shala, përpara se t'ju jap fjalën, dua t'ju kujtoj që
8 nuk do të lejojmë bërjen e deklaratave me natyrë politike. Ju
9 nuk duhet të ofendoni viktimat, Zyrën e Prokurorit të
10 Specializuar, Trupin Gjygues apo Dhomat e Specializuara si
11 institucion. Ju lutem, bëni deklaratën tuaj që të jenë në
12 lidhje me çështjen gjyqësore dhe në qoftë se ka informata të
13 cilat janë konfidenciale, ju lutem të mos i thoni ato në
14 seancë publike.

15 Ju e keni fjalën.

16 I AKUZUARI: Ju faleminderit, të nderuar Gjyqtarë, që më
17 dhatë fjalën. Dëshiroj t'ju falënderoj edhe njëherë.

18 Unë qëndroj këtu përballë jush, t'ju them që e respektoj
19 drejtësinë. Nuk i iki asaj. Asnjëherë në jetën time s'kam bërë
20 atë që më ngarkuat. Kurrë e super kurrë. Asnjëherë. Këto çka
21 më ngarkuan në aktakuzë, këto janë të panjohura për mua.

22 Unë kam qenë vetëm një luftëtar që kam luftuar për lirinë
23 e vendit tim dhe popullit tim. Asgjë më shumë, as më pak.

24 Unë kam luftuar kundër një makinerie polici, polici
25 ushtarake të një regjimi kriminal të Millosheviçit, por kurrë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata pa betim e Pjetër Shalës (Seancë e hapur)

Faqe 40

1 kundra civilëve. Kurrë. Asnjëherë.

2 Nëse është qëllimi i këtij institucioni të më dënoni pse
3 kam luftu për lirinë e popullit tim dhe vendit tim, okej, po
4 jo në këtë mënyrë të njollosem, të baltosem. Këto nuk janë
5 metodat tona. Nuk është metodë e imja dhe asnjë ushtari të
6 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk është metodë. Ne s'kemi
7 luftuar kundra civilëve. As kemi pasë të bëjmë asgjë. Me këto
8 aktakuza që më ngritën janë të panjohura për mu. S'kam asgjë
9 të bëj.

10 T'i flas edhe dy fjalë për Prokurorin. Jo me fyj, jo. Nuk
11 jam i edukum për ta fyj askënd.

12 Unë jetoj që 25 vjet, apo ma shkurt thanun, gjysëm
13 shekulli, jetoj në Belgjikë, shtet demokratik. Detyra e
14 Prokurorit, aty ku jetoj unë, është të hulumtojë, të zbulojë,
15 t'i paraqesë provat dhe të kërkojë për drejtësi. Në asnjë
16 mënyrë t'i sajojë, t'i fabriktoj. Në asnjë mënyrë. Madje aty ku
17 jetoj unë është edhe vepre penale, është e dënueshme.

18 Sa i përket Dhomave të Specializuara këtij apo këtij
19 institucioni, nuk dua të fyej, nuk e kam përkrahë asnjëherë.
20 Mirëpo, deshi fati që të jem këtu para jush. Dhe, në qoftë se
21 këtu më të vërtetë ka vetëm pak drejtësi, unë shpresoj se atë
22 drejtësi do të ma jepni të më shpallni të pafajshëm.

23 Dua t'ju them qartë dhe pa asnjë dyshim, se jam
24 plotësisht i pafajshëm për të gjitha akuzat që mu kanë bërë
25 dhe që pretendojnë të bëhen në këtë proces.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 41

1 Të nderuar Gjykatës, ju faleminderit për vëmendjen. Kaq
2 pata unë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit, z. Shala mund të uleni.

5 Pala Mbrojtëse këtu përfundojnë deklaratat hapëse nga ana
6 juaj?

7 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 Dakord. Pra, kemi përfunduar deklaratat hyrëse të të
11 gjitha palëve dhe të Mbrojtësit të Viktimave. Përpara se
12 përfundojmë këtë seancë deri në fund të marsit, është një
13 çështje të cilën duam ta diskutojmë dhe do ju jap juve mundësi
14 për të ngritur ndonjë çështje që dëshironi të ngrini përveç
15 kësaj.

16 Z. Prokuror, po ju jap fjalën lidhur me pikën që
17 diskutuam gjatë ditës së djeshme për dy ditët e seancave të
18 gjykimit.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Në
20 parim jemi të gatshëm që të sjellim dëshmitarë dhe që të
21 mbajmë seanca gjatë këtyre dy ditëve. Kemi kontaktuar me
22 kandidatë të caktuar për këto dy ditë, duke marrë parasysh
23 edhe kohën e kufizuar, siç u theksua dhe dje. Dhe sigurisht,
24 domethënë, një gjë tjetër që duhet të merret parasysh është që
25 ka një arsyetim sepse ne duam të dëgjojmë njërin dëshmitar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 42

1 para një tjetri, sepse mendojmë që renditja e caktuar e
2 dëshmitarëve i shërben narratives që duam të tregojmë. Pra, në
3 qoftë se do kemi dëshmitarë që do të mund të përdorim gjatë
4 këtyre ditëve dhe që shpresojmë që të kenë kohë të mjaftueshme
5 gjatë këtyre ditëve, sigurisht që do jua bëjmë me dije.

6 Nuk kemi dëgjuar prej këtyre dëshmitarëve, pavarësisht
7 kontakteve që kemi pasur me ta, në qoftë se ata janë të
8 disponueshëm për këto dy ditë, megjithatë do t'jua bëjmë me
9 dije sapo të kemi informacion më konkret, më prekshëm që ka të
10 bëjë me këto ditë të zhvillimit të procesit gjyqësor.

11 Mirëpresim udhëzimet tuaj, e nderuar Kryegjykatëse lidhur me
12 dorëzimin e parashtrimit jo-zyrtar përmes emailit apo jo.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
14 më mirë që të bëhet parashkrim sepse çdo gjë është
15 procesverbal dhe diskutimi është në procesverbal, kështu që do
16 preferoja që parashtrimin ta bënit me shkrim.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Faleminderit për gatishmërinë.

20 Mbrojtja e Viktimave, do shtohen dy ditët në kalendar,
21 megjithatë dua që për momentin t'ju jap mundësinë që të na
22 thoni në qoftë se keni vështirësi për të marrë pjesë në seanca
23 për këto dy ditë.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk ka vështirësi nga ana jonë.
25 Faleminderit që na pyetët.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 43

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
2 Mbrojtja?

3 ZNJ. CARILOU: [Përkthim] Ekipi jonë është i disponueshëm
4 për të dyja ditët, e nderuar Gjykatëse.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 A ka ndonjë gjë tjetër që palët dëshirojnë të ngrenë me
8 Trupin Gjygues?

9 Z. Prokuror, ndonjë gjë prej jush?

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull.

13 Mbrojtja e Viktimave.

14 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Mbrojtja e të akuzuarit.

17 ZNJ. AOUINI : [Përkthim] Jo, as ne nuk kemi gjë për të
18 shtuar. Thjesht ju falënderojmë për kohën dhe vëmendjen.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi
20 mbërritur në fund të seancës së ditës së sotme. Do të takohemi
21 përsëri më datë 27 mars me paraqitjen e provave sikurse e kemi
22 vendosur në vendimin tonë për fillimin e procesit gjyqësor.

23 Gjëja e fundit që dëshiroj të përmend janë falënderimet
24 për stenografët, përkthyesit, sekretarët, personelin
25 audioviziv dhe sigurisht, Zyrën për Menaxhimin e Seancave

Dhoma e Specializuarë të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 44

1 Gjyqësore. Faleminderit shumë për vëmendjen.

2 Seanca mbyllet këtu.

3 --- Seanca mbyllet në orën 11.34

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25